

## **Njoftim – Shkolla Verore Franko-Rumune, hapen aplikimet.**

Agjencia Universitare e Frankofonisë në Evropën Qendrore dhe Lindore (AUF-ECO) në partneritet me Universitetin Politeknik të Bukureshtit do të organizojnë edicionin e parë të shkollës verore franko-rumune : tri sfidat e zhvillimit të qëndrueshmëm : energjia, mjedisi dhe shoqëria, dedikuar studentëve të institucioneve anëtare në rajon. Kjo shkollë verore ka si qëllim promovimin e vlerave të përbashkëta akademike. Studentët do të kenë mundësi të praktikojnë frëngjishten dhe anglishten si dy gjuhë pune gjatë periudhës së shkollës verore.

Evenimenti do të zhvillohet nga data 14 deri në 20 korrik 2019 dhe Universiteti Politeknik i Tiranës do të përfaqësohet nga 4 studentë. Përveç aktiviteteve akademike, studentët do të përfitojnë edhe nga programi kulturor që përfshin eksursione dhe mbrëmje tematike.

Të interesuarit mund të aplikojnë pranë Zyrës së Karrierës, në Rektorat brenda datës **19.04.2019.**

Dosja juaj duhet të përmbajë:

1. Vërtetim studenti;
2. Letër motivimi (frëngjisht ose anglisht);
3. Dëshmi e gjuhës së huaj;